



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Bordi i FAK") në mbledhjen e vetë të datës 17.05.2017 miratoi këtë rregullore:

RREGULLORE 03/2017

RREGJISTRIMI I REKORDEVE NË FLUTURIM TË LIRË ME PARAGLLAJD DHE DELTAPLAN

Vëmendje: Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje 03/2017, shfuqizohet rregullorja paraprake 04/2015 për regjistrimin e rekordeve në FAK.

Me këtë rregullore definohet kuptimi i rekordeve sportive aeronautike që arrihen përmes fluturimit të lirë me paragllajd dhe deltaplan si dhe përcaktohen kategoritë në të cilët FAK i shënon rekordet.

Neni 1.

Kualifikimi për të regjistruar një rekord

1.1 Rekordet kombëtare dhe ato të pilotëve Kosovar regjistrohen vetëm nga pilotët e licensuar nga Autoriteti Rregullativ i Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (AAC).

Neni 2.

Definicioni i rekordit kombëtar

2.1 Me rekord kombëtar nënkuptohet një rekord i arritur/regjistruar në territorin e republikës së Kosovës ose të paktën që fluturimi i lirë ka filluar ose mbarruar (takeoff/landing) në territorin e republikës së Kosovës, nga një pilot i licensuar i Republikës së Kosovës, në një nga kategoritë e përcaktuara për regjistrim të rekordeve.

Neni 3.

Definicioni i rekordit të pilotit Kosovar

3.1 Me rekord të pilotit Kosovar nënkuptohet një rekord i arritur/regjistruar jashtë territorit të Kosovës nga një pilot i licensuar i Republikës së Kosovës, në një nga kategoritë e përcaktuara për regjistrim të rekordeve.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 4.

Kategoritë e rekordeve

Kategoritë për regjistrim të rekordeve në fluturim të lirë me paragllajd dhe deltaplan janë:

4.1 Rekordi në distancë lineare - distanca lineare maksimale e arritur

4.2 Rekordi në distancë jolineare - distanca jolineare maksimale e arritur

4.3 Rekordi i kohëzgjatjes së fluturimit

4.4 Rekordi i lartësisë maksimale të arritur gjatë fluturimit

4.5 Rekordi i lartësisë maksimale të fituar gjatë fluturimit

Neni 5.

Lajmërimi i rekordit të shënuar, verifikimi dhe zyrtarizimi i rekordit

5.1 Kryetari i komisionit përkatës të FAK duhet të lajmërohet për verifikim të rekordit. Lajmërimi bëhet nga ana pilotit i cili beson se ka shënuar një rekord kombëtar ose rekord të pilotit Kosovar në një nga kategoritë e përcaktuara për regjistrim të rekordeve.

5.2 Për të dëshmuar rekordin e shënuar piloti i dërgon komisionit përkatës të FAK regjistrimin e fluturimit (flight log) i cili duhet të jetë në formatin digjital (*.igc) dhe i njëjti të jetë i vendosur në portalin për regjistrim të fluturimeve të lira Leonardo (<http://www.paraglidingforum.com/leonardo>).

5.3 Komisioni i FAK pas pranimit të regjistrimit të fluturimit, verifikon nëse regjistrimi është autentik dhe nëse po e bënë krahasimin e rezultatit të arritur me rekordin aktual në kategorinë përkatëse. Nëse rezultati i arritur është më i mirë se rekordi aktual i regjistruar në kategorinë përkatëse atëhere komisioni e aprovon kërkesën për regjistrim të rekordit të ri.

5.4 Në rast të aprovimit të ndonjë rekordi të ri nga komisioni përkatës, sekretari i FAK zyrtarizon rekordin duke e protokoluar regjistrimin e fluturimit dhe informon klubet anëtare për rekordin e arritur, e njejta publikohet edhe në webfaqe së bashku me vegëzën ku mund të shihet edhe regjistrimi i fluturimit.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 6. Hyrja në fuqi

7.1. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FAK.

7.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, 17.05.2017

Shkelqim Krasniqi
Kryetar i bordit të FAK